



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 462/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shalai kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizerenë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhija Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prizerenë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhorë, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizerenë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizerenë, në të cilën theksohet se rreth orës 13:00 të datës 03.11.2013 Kandidati për antarë të kshilliti Komunalë në Prizeren të LDK, është hasur nga qytetarët para Qendres Zgjedhore 2008/A në shkollën fillore „Lek Dukagjini” në Prizeren , duke ju ofruar dhe ndihmuar votuesve që ta votojnë LDK-në. Në kundërshtim me nenin 4.1 pika k), të Rregullës 11/2013.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK, me datën 04.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 04.10.2013. Sipas afatit të caktuar. PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë, në të cilën theksohet se pretendimet e parashtruesit të ankesës bazohen në supozime dhe nuk ka asnjë faktë për ndonjë shkelje të mundshme , poashtu nuk rezulton të jet identifikuar nga organet e drejtsisë personi ndaj të cilit bëhet ankesa si dhe lidhja e mundshme e tij me subjektin politik LDK, si dhe nuk ka ndonjë dëshmi të bazuar në fakte për shkelje të mundshme.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstaton se pretendimet e tilla ankimore të subjekti politik PDK-së, kanë mungesë të provave, për tu bindur se kanë ndodhur parregullsi në Qendren e Votimit me nr . 2008/a si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për pa rregullësitë e për këto arsye duke u

bazuar në dispozitat ligjore të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it. PZAP-i konstatoi se një pretendimi i till është i përgjithshëm dhe i pa qartë, andaj pretendimet e tilla u vlerësuan si të pabazuar dhe ne kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 462/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike: PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*